

Vendim nr. 293 datë 11.11.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahimi,	Anëtar
Marsida Xhaferllari,	Anëtare

në datën 11.11.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 45 (A) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **AJLIN ALFREDAJ**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1088, datë 01.07.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 18, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Ajlin Alfredaj ka kryer detyrën e drejtueses vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Në vitin 2021 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kukës (*Prokuroria e Kukësit*) ka regjistruar procedimin penal ndaj saj për veprime të kryera gjatë ushtrimit të detyrës. Në përfundim të hetimeve paraprake, Prokuroria e Kukësit ka paraqitur në gjykatë kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes në ngarkim të kërkueses Ajlin Alfredaj, duke e akuzuar për veprat penale të falsifikimit të dokumenteve, kundërshtimit të punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik dhe të shpërdorimit të detyrës, të parashikuara nga nenet 186, paragrafi 3, 235, paragrafi 1 dhe 248 të Kodit Penal (KP). Po ashtu, Prokuroria e Kukësit ka kërkuar edhe pushimin e çështjes për veprën penale të veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës, të parashikuara nga neni 301 i KP-së, me arsyetimin se fakti penal nuk ekziston.

2. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, me vendimin nr. (179)69, datë 17.02.2025, ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale ndaj kërkueses për veprat penale të falsifikimit të dokumenteve dhe të shpërdorimit të detyrës, të parashikuara nga nenet 186, paragrafi 3 dhe 248 të KP-së; pushimin e çështjes për veprën penale të kundërshtimit të punonjësit që kryen një detyrë shtetërore, të parashikuara nga neni 235, paragrafi 1, i KP-së, me arsyetimin se ndjekja penale ishte shuar për shkak të dhënies së amnistisë me ligjin nr. 33/2024; pushimin e çështjes për veprën penale të veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës, të parashikuara nga neni 301 i KP-së, me arsyetimin se fakti penal nuk ekziston.

3. Gjatë gjykimit në shkallë të parë, konkretisht në seancën e datës 07.04.2025, kërkuesja ka paraqitur kërkesë për transferimin e çështjes në një gjykatë tjetër, me pretendimin se prokurori dhe gjykata e shkallës së parë nuk ishin të paanshëm. Gjykata e shkallës së parë ia ka përcjellë kërkesën Gjykatës së Lartë, e cila është përgjigjur administrativisht në datën 14.04.2025 se kërkesa duhej paraqitur e nënshkruar nga një mbrojtës dhe të shoqërohej edhe me aktin e përfaqësimit, bazuar në nenet 435/2 dhe 434/a të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe vendimin unifikues nr. 5, datë 15.09.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Pas disa komunikimeve me shkrim midis kërkueses dhe Gjykatës së Lartë për plotësimin e të metave formale, kërkuesja në datën 19.05.2025 ka paraqitur sërish pranë gjykatës së shkallës së parë kërkesën për transferimin

e çështjes në një gjykatë tjetër kompetente për shkak të rrethanave që cenojnë dukshëm perceptimin e paanshmërisë dhe garancitë e procesit të rregullt ligjor, bazuar në nenin 435/2 të KPP-së. Kjo kërkesë i është përcjellë Gjykatës së Lartë me vendimin e ndërmjetëm të datës 26.05.2025 të gjykatës së shkallës së parë.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1088, datë 01.07.2025, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se nuk plotësoheshin kushtet ligjore për transferimin e çështjes penale sipas nenit 94 të KPP-së. Sipas Gjykatës së Lartë kërkesja nuk kishte arritur të identifikonte ndonjë situatë të rëndë lokale që cenonte sigurinë publike ose lirinë e vullnetit të pjesëmarrësve në proces, nuk kishte demonstruar dëmtimin e zhvillimit të gjykitimit dhe nuk kishte provuar se mjetet e tjera procedurale ishin të pamjaftueshme për adresimin e pretendimeve të saj.

5. Në datën 28.07.2025 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar më 22.09.2025.

II

Pretendimet e kërkeses

6. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga vendimi i Gjykatës së Lartë i janë cenuar:

6.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektin e së drejtës për t'u mbrojtur, pasi asaj i është caktuar kryesisht një avokate nga gjykata, e cila nuk i ka ofruar ndihmë reale.

6.2. *Parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar rrethanat sociale dhe familjare të saj.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkeses*

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimin kushtetues.

8. Kolegji vlerëson se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

9. Një kriter tjetër paraprak është shterimi i mjeteve juridike efektive, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës. Lidhur me këtë kriter, Gjykata ka pohuar se mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet për ato vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të të drejtave. Ky rregull, në thelb, synon t’u japë organeve publike dhe në veçanti gjykatave të zakonshme mundësinë e parandalimit ose korrigjimit në substancë të shkeljeve të të drejtave kushtetuese të individit (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore të ndërmjetme, nëse plotësohen njëherazi tre kushte: (i) kur shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm; (ii) vendimi i ndërmjetëm të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe gjykatat më të larta të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që

pretendohet të jetë cenuar; (iii) vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Duke iu kthyer rastit konkret, Kolegji vëren se përmes ankimit kushtetues individual kërkesja kundërshton vendimin gjyqësor të Gjykatës së Lartë, duke ngritur pretendime për të drejtën e mbrojtjes efektive dhe të barazisë para ligjit. Mirëpo vendimi i Gjykatës së Lartë, me të cilin është refuzuar kërkesa për transferimin në një gjykatë tjetër kompetente, nuk është vendim përfundimtar në kuptimin kushtetues. Ai vendim ka natyrë procedurale për të zgjidhur një kërkesë brenda gjykimit, pra nuk i jep fund gjykimit të çështjes. Po ashtu, nuk rezulton që vendimi i Gjykatës së Lartë, në mënyrë autonome, t'i ketë shkaktuar kërkueses dëm në ndonjë prej të drejtave të saj kushtetuese, që nuk mund të riparohet gjatë gjykimit të themelit të çështjes.

12. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nuk është përfundimtar për efekt të kontrollit kushtetues dhe se kërkesja i ka të gjitha mundësitë që pretendimet me natyrë kushtetuese t'i paraqesë përpara gjykatave të zakonshme deri në Gjykatën e Lartë gjatë procesit penal të themelit dhe më pas t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se nuk plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike në dispozicion.

13. Në kushtet kur një nga kriteret paraprake nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë për shqyrtim të kërkesës bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

14. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.